



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1124 Prot.

Tiranë, më 01.11 2016

VENDIM Nr. 127, datë 25.10.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12 të datës 25.10.2016, pasi shqyrtoi projektin *Godinë banimi dhe shërbimi 3-4-6 kate me 1 kat nëntokë*, lagja 18, rr. "Paskal Prodani", Durrës, në zonën arkeologjike "B", paraqitur nga subjekti "Kristi Konstruksion 2003" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Investitori duhet të kontraktojë Institutin e Arkeologjisë dhe një shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila në bashkëpunim me këtë institucion, duhet të paraqesë pranë Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA) të radhës, konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit për sheshin ku do të ndërtohet *Godinë banimi dhe shërbimi 3-4-6 kate me 1 kat nëntokë*, lagja 18, rr. "Paskal Prodani", Durrës, në zonën arkeologjike "B", paraqitur nga subjekti "Kristi Konstruksion 2003" sh.p.k.
2. Procedura e kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit do të vijojë sipas përcaktimeve të vendimit të KKA të radhës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO